



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 122, Datë 04.04.2023

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME  
KËRKESËN E SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË”(FTL) SH.A. PËR  
RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 999/4 prot., datë 31.03.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 77, datë 15.03.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.03.2023 dhe 17.03.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me e-mailin e datës 31.03.2023, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për të zgjatur me 5 (pesë) ditë afatin për plotësimin e dokumentacionit të mbetur ende pa plotësuar, për arsye se është i shpërndarë në vite dhe është voluminoz.
- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për

marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim që t'i jepet mundësia shoqërisë të plotësojë dokumentacionin përkatës, duke përllogaritur më pas dhe kohën për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga ana e saj, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë FTL sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 20 (njëzet) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., për rinovimin e licencës për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**